



REPUBLIKA E SHQIPERISË
GJYKATA E APELIT TIRANË
KOLEGJI ZGJEDHOR

NR. 70 AKTI

NR. 67 VENDIMI

Data e Rregjistrimit 06.06.2011

Data e vendimit 13.06.2011

V E N D I M

" NË EMËR TË REPUBLIKËS "

Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, i përbërë prej:

KRYESUESE	:	DHURATA HAVERI
ANËTARË	:	ASTRIT KALAJA
ANËTARË	:	SASHENKA JONUZI
ANËTARË	:	MARIE QJRLAZI
ANËTARË	:	MERIDAN MUTLAJ



Asistuar nga sekretare *Yllka Çika*, sot me datë *13.06.2011*, mori në shqyrtim në seance gjyqësore me dyer të hapura, çështjen administrative me Nr.Regj.70, që i përket paleve :

PADITËS : Partia Socialiste e Shqipërisë e përfaqësuar me autorizim Nr.475 akti me datë 13.06.2011, nga av. *Arjan Salati, av.Eridian Salianji dhe z. Damian Gjïknari dhe z. Saimir Tahiri.*

IPADITUR : Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Tiranë, përfaqësuar me autorizim Nr.5103, me datë 13.06.2011, nga *Deshira Pasko.*

PALE E INTERESUAR : Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim Nr. Extra dt.13.06.2011 nga *Ivi Kaso dhe Oerd Bylykhashi.*

OBJEKTI : Kundërshtimin si të paligjshëm të pikave " 2 " dhe " 3 " të Vendimit Nr.827, datë. 02.06.2011 të KQZ-së që ka vendosur rrëzimin e kërkesës ankimore Nr.161 dhe Nr.162 lidhur me vendimin Nr.710 dhe 711, datë 23.05.2011 të KQZ-së si dhe të të gjithë vendimeve të marra nga KQZ, për nxjerrjen e rezultatit përfundimtar për Kryetarin e Bashkisë Tiranë, si vendime në kundërshtim flagrant me ligjin duke rivendosur në vend të drejtën e cënuar.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 21, 23, 24, 25, 117, 118, 119, 122, 123, 145,



152, 153, 155, 156, 158 të Kodit Zgjedhor, si dhe
 art. 324 e vijues të Kodit të Proedurës Civile.

Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, pasi administroi provat e paraqitura, pasi dëgjo i përfaqësuesit ligjore të palës paditëse, Partia Socialiste e Shqipërisë që kërkoi pranimin e kërkesë padisë së paraqitur sipas objektit të saj dhe shpalljen fitues të kandidatit deri në atë moment.

Përfaqësuesin e palës së paditur KQZ, Deshira Pasko, që kërkoi rrëzimin e kërkesë padisë, si të pabazuar në prova dhe në ligj, përfaqësuesit e palës së interesuar, Partia Demokratike e Shqipërisë, Ivi Kaso dhe Oerd Bylykbashi që kërkuan rrëzimin e kërkesë padisë dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi.

V E R E N

Se, vendimi Nr.827, datë 02.06.2011, i KQZ-së është rrjedhojë e mosrespektimit të rregullave për garantimin e respektimit të parimeve për një proces të rregullt ligjor, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë sipas rregullave të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe si i tillë duhet të anulohet në pikat 2 dhe 3 të tij, përse ka disponuar për rrëzimin e kërkesës ankimore Nr.161 dhe Nr.162, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë:

Rrethanat e faktit:

Me vendimin Nr.827 me dt. 02.06.2011 KQZ -ja ka vendosur :

1-*“Rrëzimin e kërkesës ankimore, Nr.160, të subjektit Partia e Bashkimit Popullor i Pensionistëve të Shqipërisë, me objekt kundërshtimin e vendimit Nr.711, me datë. 23.05.2011 për nxjerrjen e rezultatit të votimit për Kryetar për zonën zgjedhore Bashkia Tiranë Qarku Tiranë.”*



2- "Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.161 të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë me objekt kundërshtimin e vendimit Nr.710, me datë 23.05.2011 për nxjerrjen e rezultateve të votimit për Kryetar për ZAZ-në Nr.49, Qarku Tiranë."

3-"Rrëzimin e kërkesës ankimore Nr.162, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë me objekt kundërshtimin e vendimit Nr.711, datë.23.05.2011, për nxjerrjen e rezultatit të votimit për Kryetar për zonën zgjedhore, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë si të pambështetur në ligj."

4-"Rrëzimin e kërkesës ankimore Nr.162, të subjektit Partia Demokratike me objekt kundërshtimin e vendimit Nr.711, me datë. 23.05.2011, për nxjerrjen e rezultatit të votimit për Kryetar për zonen zgjedhore, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë."

Pala paditëse në këtë proces, Partia Socialiste e Shqipërisë në kërkesë padinë e rregjistruar me Nr. Regj. Them.70, datë 06.06.2011, ka kundërshtuar vendimin e mësipërm Nr.827, datë 02.06.2011, të KQZ-së në pikën "2" dhe "3" të tij.Ky kundërshtim vjen përse është disponuar nga KQZ në këtë proces për rrëzimin e kërkesave ankimore Nr.161 dhe Nr.162, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, me objekt, kundërshtimin e vendimit Nr.710 datë.23.05.2011 të KQZ dhe Nr.711, datë 23.05.2011 të KQZ-sc. Padia bazohet në nenin 42 të Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë neni 21, 22, 24, 35, 117, 118, 119, 122, 123, 145, 152, 153,155,156 dhe 158 të Kodit Zgjedhor si dhe neni 324 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Pretendimet e palës paditëse:



Referuar përmbajtjes së objektit të padisë, bazës juridike të saj dhe argumentimit të palës paditëse në kërkesë padi, rezulton se pretendimet kryesore të saj renditen si më poshtë:

a) Janë cënuar standartet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të pasqyruara këtu në gjithë procesin administrativ të zhvilluar nga pala e paditur në këtë proces KQZ, (duke përfshirë këtu cënimin e parimeve lidhur me kompetencën, juridiksionin, paanshmërinë e organeve administrative, marrjen e attributeve të organeve të tjera, procedurën ekstraligjore të ndjekur, etj) që kanë çuar në :

Sw pari: Në përfundim të procesit të numërimit të votave për kandidatet për Kryetar të Bashkisë Tiranë dhe për Këshillin e Bashkisë Tiranë, KZAZ Nr. 49, me vendimin Nr. 37, datë 16.05.2011, ka vendosur të mos miratojë tabelën përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjet e Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Procesi ligjor ka filluar të deformohet që nga ky moment dhe shkeljet e kanë shoqëruar të gjithë procesin deri në përfundimin e tij nga KQZ-ja. Mosmiratimi i këtij veprimi nga KZAZ-ja ndërkohë që janë hedhur të gjitha tabelat në rezultatit e procesit të numërimit sipas atyre të hartuara nga GNV-të është shkelja e parë e ligjit që vjen si mospërbushje e detyrimit ligjor që parashikon nga neni 35 dhe 122 të Kodit Zgjedhor, nga KZAZ-ja Nr 49.

Së dyti: Vendimi Nr. 711, datë 23.05.2011 i KQZ-së është rrjedhojë e veprimeve në kundërshtim me ligjin pasi ky vendim nuk pasqyron rezultatit e zonës zgjedhore Bashkia Tiranë sipas përcaktimeve të neneve 122 e 123 të Kodit Zgjedhor.

Vendimi Nr. 711 datë 23.05.2011 ka shpallur një rezultat për zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, por duke ndryshuar të gjitha vendimet e marra nga




KZAZ-të. Ndryshimi që është bërë pa asnjë vendim sipas parashikimeve të nenit 35, 122 dhe 123 të Kodit Zgjedhor, gjë që e bën të jetë në kundërshtim me ligjin.

Së treti: Vendimi Nr. 711 datë 23.05.2011 i KQZ-së vjen në kundërshtim me vendimin Nr. 650, datë 16.05.2011, të KQZ-së i cili ka përcaktuar procedurat për nxjerrjen e tabelës përmbledhëse të rezultatit prej saj.

Së katërti: Vendimet Nr. 710 datë 23.05.2011 dhe Nr.711 datë 23.05.2011, janë në kundërshtim me ligjin dhe për faktin se në të dyja rastet KQZ-ja ka realizuar një procedurë ndryshimi të tabelave të rezultateve të QV-ve model 56-11 me një vendimarrje që vjen në kundërshtim me procedurën e parashikuar nga neni 123 i Kodit Zgjedhor dhe parashikimet e nenit 116, 117, 118 dhe 119 të Kodit Zgjedhor.

Së pesti: Vendimet Nr. 710 dhe Nr. 711 të KQZ-së janë të paligjshëm gjithashtu dhe për shkak se vlerësimet e bëra nga KQZ-ja në procedurën hetimore të përmbyllur në vendimin Nr.709, lidhur me vlefshmërinë apo pavlefshmërinë e atyre fletëve të votimit të kontestuara që janë gjëndur në kutinë e gabuar (atë jorespektive) janë në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Zgjedhor.

Së gjashti: Me rivlerësimet e bëra dhe në vendimin Nr. 710 dhe Nr. 711 KQZ-ja ka treguar edhe një aspekt tjetër të paligjshmërisë së veprimeve të veta, gjë që ka çuar mospërputhje në aktin e kryer të vullnetit të zgjedhësve me votat e gjetura në kuti, gjë që do të thotë se në tabelat e GN-ve dhe KZAZ-ve, mbas një hetimi të kryer me një procedure të rregullit duhet që këto tabela të pasqyrojnë saktë dhe në përputhje të plotë çdo vullnet në çdo votë. Nga verifikimi i tabelës përfundimtare rezultoi se nuk përputhet asnjë



komponent i mësipërm që do të thotë se tabela e rezultetit është një tabelë alogjike në lidhje me shifrat dhe nuk mbështetet mbi të dhëna reale.


Të gjitha këto shkelje të sipërcituara sipas palës paditëse kanë çuar në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave perkatëse të Kodit Zgjedhor e të Kodit të Procedurave Administrative në terësinë e tij në një proces të parregullt ligjor që konsiston në cënimin e parimit të sigurisë juridike, parimit të barazisë së votës, parimit e fshehtësisë së votës, lirinë e votuesve për të shprehur lirisht vullnetin e tyre etj.

II-Prapësimet e palës së paditur:

1.Lidhur me pretendimin e palës paditëse, subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, për kundërshtimin e vendimit Nr.710 datë 23.05.2011, të K.Q.Z-së për nxjerrjen e rezultetit për kryetar për Z.A.Z nr. 49 për faktin se K.Z.A.Z-ja nuk mori vendim për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultetit , për zonën administrimit zgjedhor Nr.41, pas miratimit të grupeve të numërimit, propozuar K.Q.Z-së, kjo e fundit ka vepruar në përputhje me kompetencat e K.Z.A.Z-së sipas nenit 33 gërma "c" të Kodit Zgjedhor duke kryer shqyrtimin e fletëve të votimit të pa vlerësuara dhe të pa numëruara që referohen në dokumentacionin e K.Z.A.Z-ve kërkuese.

2.Në ankimin e bërë në K.Q.Z, kundër vendimit Nr.710, datë 23.05.2011 dhe Nr.711, datë 23.05.2011, ankesi në asnjë rast nuk ngriti pretendime në lidhje me vlerësimin e votës si të vlefshme apo ta pavlefshme, të bërë nga K.Q.Z-ja, për ato fletë votimi të hedhura aksidentalisht në kutinë e gabuar.

Pretendimi se vlerësimi i votëve të votimit, të cilat sipas vendimit Nr.709, datë 23.05.2011, është i gabuar është një pretendim i cili ngrihet për herë të parë para Kolegjit Zgjedhor.



Pretendimi se vullneti i zgjedhësve duhet të përputhet me votat e gjetura në kuti, pas një hetimi të kryer me një procedurë të rregullt ligjore duhet që këto tabela të pasqyrojnë saktë dhe në përputhje të plotë çdo vullnet më çdo votë, nuk qëndron dhe ngrihet për herë të parë në Kolegjin Zgjedhor.

Pala paditëse ka ngritur pretendimin në lidhje me paligjshmërinë e vendimit Nr. 710, datë 23.05.2011 dhe Nr. 711, datë 23.05.2011, në lidhje me veprimet dhe vendime të cilat KQZ-ja i ka miratuar me vendimin Nr. 709, datë 23.05.2011.

Ligjshmërinë e vendimit Nr.709, datë 23.05.2011 e konfirmon Kolegji Zgjedhor me vendimin Nr. 49, datë 03.06.2011.

Kërkesat e Partisë Socialiste për kundërshtimin e vendimit Nr.827, datë 02.06.2011, nxjerja e rezultatit të votimit për Kryetar për zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, mbi bazën e tabelave të K.Z.A.Z-së është e pambështetur në prova dhe në kundërshtim me Kodin Zgjedhor.

III-Prapësimet e palës së interesuar Partia Demokratike e Shqipërisë

1.Lidhur me pretendimin e parë të parashtruar nga pala paditëse, theksohet se K.Z.A.Z, Nr.49 ka vendimin të miratimit për tabelat përmbledhëse të rezultateve.



Vendimi Nr.710, datë 23.05.2011 i K.Q.Z-së për nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar në K.Z.A.Z-së Nr.49, është vendimi i ndërmjetëm në zbatim të nenit 35 pika "5" të Kodit Zgjedhor. Vendimet e ndërmjetme gjatë zhvillimit të një procesi administrativ, janë vendime që nuk përfaqësojnë fundin e procedimit administrativ të një çështje të caktuar. Vendimi i ndërmjetëm, nuk mund të jetë objekt kontesimi më vete. Përsa kohë është goditur juridikisht vendimi Nr.710, datë 23.05.2011 është goditur edhe vendimi Nr.711, datë 23.05.2011.

Pretendimi i dytë, lidhur me kundërshtimin e vendimit Nr.711, datë 23.05.2011 të K.Q.Z-së për faktin se është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 122 e 123 të Kodit Zgjedhor është një çështje e gjykuar prej Kolegjit Zgjedhor me vendimin Nr.49, datë 03.06.2011.

Analiza e vendimit Nr.650, datë 16.05.2011, qartëson menjëherë dy qëllime që K.Q.Z-ja ka synuar të arrijë nëpërmjet atij vendimi, sipas përcaktimeve në pikën "1" dhe "2" të tij dhe vendimi Nr.709, datë 23.05.2011, i lënë në fuqi nga Kolegji Zgjedhor me vendimin Nr.49, të datës 03.06.2011, ka urdhëruar lëshimin e tabelave të grupit të numërimeve dhe K.Z.A.Z-ve të zonës zgjedhore Bashkia Tiranë, gjë që passjell veprimin në mënyrë konsektive të vendimit Nr.650, me vendimin Nr.709, datë 23.05.2011.

Lidhur me pretendimin se K.Q.Z-ja ka vepruar në kapërcim të kompetencave të saj dhe se ndryshimi i bërë është i ndryshëm nga ai i korrigjimit të gabimeve material, i vetmi i lejuar nga neni 123 i Kodit Zgjedhor, bie poshtë me argumentet e parashtrura në arsyetimin e vendimit të Kolegjit Nr.49 datë 03.06.2011.

Lidhur me pretendimin e pestë të parashtruar nga paditësi, për vlerësimin e fletëve të votimit, në koncept ose jo të nenit 117 të Kodit Zgjedhor përgjigjet gjenden në një vendim gjyqësor të formës së prerë. Vendimi i Kolegjit Nr. 49, datë 03.06.2011 (faqja 17-18 të tij).




Lidhur me pretendimin e gjashtë të parashtruar në kërkesë padi, për mos rakordimin e shifrave në tabelën përmbledhëse të rezultatit, argumentet gjenden në dokumentin e përpiluar nga Komisioni i Venecias (studimi i tij në vitin 2010).

Pretendimi si më sipër i palës paditëse lidhur me mos rakordimin e shifrave në tabelën përmbledhëse është një argumentim i ri, i cili paraqitet për herë të parë në Kolegjin Zgjedhor dhe nuk është paraqitur përpara K.Q.Z-së gjatë shqyrtimit administrativ të mosmarrëveshjes. Si i tillë nuk duhet të shqyrtohet nga kolegji dhe të rrëzohet, pasi është një pretendim i cili nuk mund të ngrihet. Kolegji Zgjedhor nuk ka juridiksion fillestar në shqyrtimin e pretendimit të palevë, në procesin ankimor zgjedhor. Këtë juridiksion fillestar e ka vetëm K.Q.Z-ja për shkak të një parashikimi specifik të shprehur në ligj.

Në padi pretendohet se mos rakordimi i shifrave në tabele vjen si pasojë e mos rakordimit të prodhuar nga 117 tabelat të cilat pasqyrojnë rezultatit në 117 kuti të hapura dhe vlerësuara nga K.Q.Z, si dhe nga mos rekordimi në tabela qendra të tjera votimi. Ky pretendim nuk mund të ngrihet pasi rezultati i dalë nga këto 117 përbën tashmë gjë të gjykuar.

Ai pasqyrohet në anekset e vendimit Nr.709, datë 23.05.2011 të K.Q.Z-së, është pjesë integrale e tij dhe pasi u gjykua nga Kolegji Zgjedhor u vlerësuar si i ligjshëm dhe si i tillë nga mbetur në fuqi, për pasojë dhe mos rakordanca e shifrave për rezultatit e dalë nga 117 kuti përbën gjë të gjykuar.



Pretendimi i ngutur kështu me qendra të tjera votimi, parashtrohet nga paditësi për herë të parë përpara këtij kolegji, jashtë çdo lloj afati, pa u shqyrtuar më parë administrativisht dhe si i tillë nuk mund të sqyrtohet.

Ligji i zbatueshëm

Neni 6 pika "1" i Konvetës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Ratifikuar me Ligjin Nr.8137, datë 31.07.1996 parashikon se :

"Cdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshëm e krijuar me ligj, e cila do të vendos si për mos marrëveshjet në lidhje me të drejtat e detyrimeve të tij të natyrës civile, ushtu edhe për bazueshmërinë e cdo natyrës penale që i është drejtuar"

Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

1."Liria, pronu, dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të çënohen pa një proces të rregullt ligjor."

2."Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij Kushtetuese dhe ligjor,.... ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj".

Neni 3 i Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, në parimet e përgjithshme në pikën dy të tij parashikon se :



2."Zgjedhjet bëhen në votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtëpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë kod. Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e votës".

Në pikën "4" të nenit 3 thuhet se :

4."Cdo zgjedhës ka të drejtën e vetëm një vote për zgjedhjen e një subjekti zgjedhor."

Në vijim në ligjin e sipërcituar në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, në dispozitat neni 21, 22, 24, 35, 117, 118, 119, 122, 123, 145, 152, 153, 155, 156 dhe 158 të Kodit Zgjedhor si dhe nenet 324 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, rregullohen kompetencat, juridiksioni, të drejtat e organit administrative, sipas formulimeve në këto dispozita.

Arsyetimi ligjor.

A) Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit çmon të bazuar pretendimet e palës paditëse PSSII-së, për cënim të standarteve kushtetuese dhe të drejtës për proces të rregullt ligjor që parashikohen nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut ,parimet e përgjithshme të Kodit Zgjedhor.Keto pretendime konsistojnë në,në shkeljen e parimit për vlerësim të barabartë të votës, në ruajtjen e një standarti në hetimin administrativ, pasqyrimin e vullnetit të cdo zgjedhësi që shprehet me votën e tij.

B) Gjykatës i është paraqitur për shqyrtim një padi e natyrës administrative, për shqyrtimin e së cilës vlejné rregullat e gjykimit *suu generis*, të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile (nenet 324-333), Kodin e Procedurave Administrative dhe në Kodin Zgjedhor të miratuar me Ligjin Nr 10019/2008. Në kuptim të dispozitave ligjore të mësipërme, objekt i kontrollit gjyqesor *ex post* përcëptohej ligjshmëria e aktit administrativ të



kundershtuar. Kjo nënkupton verifikimin e faktit të respektimit të kriterëve ligjore lidhur me formalitetin e aktit ashtu si dhe disponimin themelor përmes vendimmartjes. Vlefshmëria e aktit administrativ kushtëzohet me ligjshmërinë e tij.

Në vlerësim të pretendimeve dhe prapësimeve të palëve, së provave të administruara në këtë proces gjyqësor, që vijnë në s: më poshtë

1-Vendimi Nr.827, datë 02.06.2011 i KQZ së (55 fletë); 2-Vendimi Nr 710 e 711, datë 23.05.20110 të KQZ; 3.Vendimi Nr.113, datë 02.06.2011 të KQZ; 4-Vendimi Nr.448, datë 18.04.2011 i KQZ; 5-Vendimi Nr.541, datë 06.05.2011i KQZ; 6-Tabelat e rezultateve të 485 QA;7-Tabelat përmbledhëse të rezultateve dhe vendimet e miratuara të tyre të KZAZ Nr.45,46, 47,48,49,50,51,52,53,54 e 55; 8-Procesverbale të përmbledhjeve të KQZ të shqyrtimit të kërkesave ankimore Nr.160,161,162,16; 9-Procesverbal i mbledhjeve se KQZ datë 23.05.2011 për vlerësimin e fletëve të votimit të pavlerësuarra dhe të panumëruara për Kryetarin e Këshillin e Njësite Bashkiake Tiranë; 10-Procesverbal i mbledhjes së KQZ datë 18-22-5.2011;11-Procesverbal i mbledhjes së KQZ datë 23.05.2011, për diskutimin e projekt vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse të KZAZ Nr.49; 12- Procesverbal i mbledhjes së KQZ datë 23.05.2011, për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zonën zgjedhore Bashkia Tiranë; 13- Procesverbal i mbledhjes së KQZ datë 16.05.2011, jashtë rendit të ditës; 14- Procesverbal i mbledhjes së KQZ datë 18.02.2007, për diskutimin e projekt vendimit për shqyrtimin ankimore të PS, në lidhje me gjetjen e fletëve të votimit në kutinë e gabuar; 15- Vendimi Nr.82, datë 24.03.2007 i Kolegjit Zgjedhor Tiranë për Bashkinë Durrës; 16- Vendimi Nr.42, datë 08.06.2011 i Kolegjit Zgjedhor; 17- Vendimi Nr.49, datë 03.06.2011 i Kolegjit Zgjedhor; 18- Vendimi Nr.53, datë 08.06.2011 i Kolegjit Zgjedhor;19- Deklarata të anëtarve të 11 KZAZ-ve; 20-Kërkesa e subjektit PD dhe kërkesat e disa KZAZ për votat në kutinë e gabuara datë 16.05.2011;21- Raport i vëzhguesve vendor dhe një CD; 22- Vendimi Nr.710 e 711, datë 23.05.2011 të KQZ 23-kërkesë ankimore Nr. 161, 162 datë 26.05.2011; 24- Vendimi Nr.827, datë 02.06.2011; 25- Vendimi Nr.709, datë 02.06.2011; 26-Buletine të vitit 2003,



2005 e 2007; 27- Tabela të rezultatit të QV Nr.1875/1 KZAZ 50; 28- Kopje të vlerësimit shqip për praktikën zgjedhore Nr.CDI-AD 2002 të Komisionit të Venecias; 29- Raporti nr.CDI-AD 2010 të Komisionit të Venecias; 30- Vendimi Nr.49 datë 03.06.2011 i Kolegjit Zgjedhor, konstatohet se:

Në procedurat e ndjekura në zgjedhjet e 8 Majit 2011 pala e paditur, KQZ-ja, për zgjidhjen e situatave juridike të krijuara, duke e gjetur vetën në respektim të neneve 2 pika "7", neni 21 pika "1", "2", "3" dhe pika "11", neni 28, neni 29, neni 35 pika "5" dhe neni 42 pika "5" i Kodit Zgjedhor, në ushtrim të parimit të organit administrativ hierarkik më të lartë dhe përgjegjës për përgatitjen, mbikqyrjen, drejtimin dhe verifikimin e aspekteve të zgjedhjeve dhe të së drejtës për ushtrimin e kompetencës së organeve të varësisë, kur ato nuk i ushtrojnë ose kanë pamundësi për t'i ushtruar i ka lejuar vetës ushtrimin e funksionit të saj si KZAZ, sipas një procedure të ndjekur për hetimin administrativ primar dhe jo hetim i ankimuar.

Ky hetim administrativ ka marrë spunto dhe ka përfshirë këto momente për këto shkaqe:

- Nga KZAZ-ja me nr 46, KZAZ-ja nr 47, KZAZ-ja nr 48, KZAZ-ja nr 49, KZAZ-ja nr 51, KZAZ-ja nr 50, KZAZ-ja nr 53, KZAZ-ja nr 54 dhe KZAZ-ja nr 55 si njësi të qeverisjes vendore Bashkia Tiranë si dhe kërkesa e subjektit zgjedhor Partia Demokratike me shkresën Nr. 4512, datë 17.06.2011 pas konstatimit të faktit të hedhjes në kutinë e gabuar të fletëve të votimit për Kryetarin e Bashkisë, Këshillin e Bashkisë Tiranë, Kryetarin e Njesisë Bashkiake dhe Këshillin e Njesisë Bashkiake të së njëjës qëndër votimi kanë aktivuar KQZ-në gjatë procesit zgjedhor.
- Duke u gjendur pranë mungesës së një procedure uniforme në trajtimin e fletëve të votimit të vlerësuara si më sipër të cilat janë konsideruar të kontestuara, të veçuara dhe vendosur ato herë në zarfin e fletëve të kontestuara dhe herë në zarfin e fletëve të pavlefshme.
- Duke pranuar se në përgjithësi këto fletë janë konsideruar të kontestuara për arsye se pavarësisht se nuk plotësohen elementet formale të përcaktuar nga neni 117/3 e Kodit Zgjedhor për t'u konsideruar si të tilla ato nuk i përkasin



procesit të numërimit gjatë të cilit janë evidentuar dhe për pasojë nuk janë vlerësuar dhe pasqyruar në tabelën e rezultateve. Veçimi i tyre, pavarësisht se janë konsideruar të kontestuar, është kryer duke i vendosur ato herë në zarfin e fletëve të kontestuar dhe herë në zarfin e fletëve të pavlefshme.

- Në Vendimin Nr.709, datë 23.05.2011, konstatohet se K.Z.A.Z-te janë gjëndur pranë mungesës së një procedure uniforme në trajtimin e fletëve të votimit të vlerësuar si më sipër. Ky është motivi që këto lloj fletësh janë vendosur herë në zarfin e fletëve të pavlefshme dhe herë në zarfin e fletëve të kontestuar.

Në gjykim u provua se këto fletë deri me datë 14 Maj moment kur përfundoi votimi i votave për Kryetar të Bashkisë Tiranë, janë konsideruar nga numëruesit e të dy subjekteve zgjedhore palë në proces si të pavlefshme, e pas kësaj date janë konsideruar të kontestuar. Sic u konstatua gjatë hetimit gjyqësor kjo provon faktin e mungesës së shënimeve në librat e portokollit të 11 K.Z.A.Z-ve të Bashkisë Tiranë, për fletët e hedhura në kutitë e gabuara deri në datën 14 Maj.

Kolegji çmon se statusi i këtyre fletëve të cilat nuk janë kontestuar më parë, pasi me konsensus janë trajtuar më parë si të pavlefshme, të konsiderohen si fletë të kontestuar të pa numëruara më parë. Këtë qëndrim ka mbajtur K.Q.Z-ja ku në vendimin Nr.709, i ka konsideruar të gjitha vlerësimet dhe vendimet e GN-ve e K.Z.A.Z-ve për këto fletë të hedhura në kutinë e gabuara duke i bërë këto fletë pa një status të përcaktuar qartë ligjorisht, duke i dhënë statusin e fletëve të kontestuar dhe të pa numëruara më parë.

Është pranuar se në të gjitha rastet KZAZ-të e qeverisjes vendore Bashkia Tiranë nuk i kanë përfshirë në rezultate këto fletë votimi të hedhura në një kuti tjetër votimi të së njëjtës qendër votimi.

Duke u gjetur si i “*papërkthyer*” vullneti i zgjedhësve në favor të asnjërit subjekt zgjedhor garues në zgjedhjet vendore datë 08-05-2011 nga KQZ-ja në vlerësim të respektimit të kritereve të nenit 116, 117 dhe 118 të Kodit



Zgjedhor ka bërë leximin e tyre që çili përfshin 117 kuti në në 108 QV-të të përcaktuara.

Rezultatet e tyre janë pasqyruar në tabelën përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhore Bashkia Tiranë.

Në respektim të kriterëve të zbatuara në nenin **117** të Kodit Zgjedhor në funksion të ushtrimit të parimeve të ushtrimit të së drejtës së votës, të lirë, të fshehtë dhe të barabartë si dhe duke u pranuar nga pala e paditur prej KQZ-së së hedhja e votës prej zgjedhësit në një kuti tjetër të së njëjtës qëndër votimi nuk e bën fletën e votimit të pavlefshme janë nënshtruar hotimit administrativ vetëm vendimet e K.Z.A.Z-ve lidhur me shpalljen si të pavlefshme të fletëve të votimit të cilat janë hedhur në kuti tjetër të së njëjtës qëndër votimi prej **117** kutish. Referuar gjëndjës së faktit, natyrës së votimit të ndodhur në Bashkinë Tiranë ku zgjedhësi voton me katër fletë votimi, për Kryetarin e Bashkisë, Këshillin Bashkiak, Kryetarin e Njësisë Bashkiake dhe Këshillin e Njësisë Bashkiake zgjedhësit duhet të shprehin vullnetin nëpërmjet votës në katër fletë votimi sipas përcaktimeve të nenit 27 pika "4" të Kodit Zgjedhor.

Referuar nenit 122 pika "6" të Kodit Zgjedhor për zgjedhjet e Kryetarit dhe Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë, K.Z.A.Z miraton tabelën përmbledhëse të rezultateve të QV-ve të Njësisë Bashkiake përkatëse. Po sipas këtij neni kopja origjinale e tabelës përmbledhëse të rezultateve dhe tabelat e rezultateve për çdo qëndër votimi i dërgohen K.Q.Z për të nxjerr sipas nenit 123 të këtij kodi rezultatit në respektim të urdhorimeve të parashikuara nga ligjvënosi.

Në vijim të nenit 123 pika "1" të Kodit Zgjedhor në kushte normale të një procesi zgjedhor K.Q.Z-ja, nxjerr rezultatet e votimit për zonat zgjedhore në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo K.Z.A.Z e zonës zgjedhore përkatëse që në rastin konkret janë 11 K.Z.A.Z e Bashkisë Tiranë, në




përbërje të të cilave ka produktin që vjen nga tabelat e rezultateve të qendrave të votimeve (485 QV) të miratuara nga këto KZAZ.

Me këtë logjike juridike kur K.Q.Z-ja gjatë llogaritjes së tabelës, voren, konstaton mospërputhje të shifrave të tabelës përmbledhëse me tabelat e rezultateve të QV-ve, merri vendim për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit me shifrat e korigjuara duke u bazuar në origjinalet e tabelave të qendrave të votimit.

Në rastin konkret gjendëmi përpara një produkti, Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit, që nuk është produkt i ardhur nga kalimi i këtyre hapave procedural, por ekstra procedural dhe që në vetvete mbart një përfundim ku, nga leximi i së cilës (tabelës) rezulton se kemi mos përputhje ndërmjet numrit të fletëve të votimit dhe numrit të zgjedhësve. Nga analiza e këtyre tabelave të administruara dhe të shqyrtuara si prova në shqyrtimin gjyqësor, rezulton se nga shpërndarja e votave të gjëndura në kullitë e votimit të kesaj njësie zgjedhore, (sipas tabelës përmbledhëse të rezultatit për Kryetar Bashkia Tiranë), kemi një mospërputhje që konsiston në faktin që, votat e gjëndura në kullitë e votimit të jenë në numër më të madh se numri i zgjedhësve që kanë votuar, duke cënuar parimin një zgjedhës një votë.

Gjendur përpara një mospërputhjeje të tillë matematikore dhe një situatë juridike të trajtimit të procesit zgjedhor nga pala e paditur K.Q.Z-ja me procedura hetimi administrativ dhe standarte të ndryshme, selektive, nga ku rezultati origjinal i 485 QV-ve për 11 K.Z.A.Z-të e zonës zgjedhore përkatëse i është nështruar aplikimit të procedurave të ndryshme për pjesë të ndryshme të tabelës përmbledhëse të rezultatit. Kjo nëpërmjet hetimit administrativ të kryer prej saj, me ndërhyrje në hetim në 117 kuti, që i përkasin 108 QV-ve, rezultatet e të cilave janë pasqyruar në tabelën Përmbledhëse e Rezultatit për Kryetar Bashkie Tiranë.



Nga Kolegji Zgjedhor në analizë të kësaj situatë juridike vlerësohet se, në rastin konkret, gjendemi përpara një hetimi të pjesshem, i cili në vetvete ka prodhuar një tabelë përmbledhëse me mospërputhje në lidhje me shifrat, dhe që nuk pasqyron vullnetin e të gjithë zgjedhësve. Kjo ka ardhur për shkak se është kryer nga K.Q.Z-ja hetim administrativ i paplotë, selektiv, që nuk trajton me te njejtën procedurë rezultatin origjinal të 485 QV-ve, por mjaftohet vetëm me hetimin administrativ të pjesshëm të një numri të kufizuar kutishë, dhe përfshirjen e rezultatit të tij, pra të një pjesë të së tërës, pa ja nënshtruar logjikën e përdorur nga K.Q.Z. tabelës përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhore në terësinë e saj. Në rastin konkret K.Q.Z-ja është mjaftuar me ndërhyrjen në pjesë të veçanta të saj duke konkluduar në një produkt me mospërputhje në shifra ku numri i fletëve të votimit nuk rakordon me numrin e vullnetëve të shprehura (numrin e zgjedhësve).

Veprimi si më sipër i K.Q.Z-së nga Kolegji Zgjedhor vlerësohet si veprim në shkelje të parimeve për një proces të rregullt ligjor që në zanafillë të tij ka mosrëspektimin e parimit të barazisë dhe paanësisë, sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës së Shqipërisë, mishëruar në nenin 3 pika "2" të Kodit Zgjedhor në të cilin thuhet se: *"Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtëpërdrejtë sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod."*

Në nenin 3 pika "4" të Kodit Zgjedhor parashikohet se *"Cdo zgjedhes ka të drejtën e vetem një votë për zgjedhjen e një subjekti zgjedhor"*

Në zbatim të sa më sipër Kolegji Zgjedhor vlerëson se nga pala e paditur K.Q.Z-ja nuk janë patur parasysh dhe vlerësuar drejtë garancitë ligjore të palëve gjatë procesit, kur është lejuar aplikimi i procedurave të ndryshme brenda një procesi zgjedhor e fokusuar në një KZAZ, që ka në përfundim të tij një tabelë përmbledhëse të rezultatit me mosrakordim shifrash.

Në vështrim të nenit 138 pika "1" të Kodit Zgjedhor K.Q.Z-ja kur ka pranuar kërkesën e palëve për hetim administrativ, ka qyr dokumentacionin dhe



materialin zgjedhor që ndodhet në kutitë e materialeve zgjedhore dhe / ose kutitë e votimit dhe fletët e votimit si dhe çdo dokumentacion apo material tjetër zgjedhor, veprim i cili është ndërmarrë kryesisht edhe nga vetë K.Q.Z-ja.

Në këtë kuptim hetimi administrativ nëpërmjet hapjes, kqyrjes dhe vlerësimit të të gjitha fletëve të hedhura jo në kutinë përkatëse, pavarësisht nga zarfi ku ndodhen (zarfi i fletëve të pavlefshme apo të kontestuara) pavarësisht faktit nëse ka apo jo shënime në librat e protokollit të KZAZ-ve që reflektojnë mosmarveshjet në vendimarrje në lidhje me këtë fletë, i shtrirë në 117 kurtashme duhet të shtrihet në diferencën e QV-ve midis zonës së nënshtuar pjesërisht hetimit administrativ dhe pjesës së mbetur të QV-ve në Zonën Zgjedhore të Bashkisë Tiranë, që përfaqëson 368 QV-ve të patrajtuara me parë, ose dhe më gjërë

Ky hetim i plotë do të kryhet në të gjitha kutitë e votimit kutia e votimit për Kryetarin e Bashkisë, Këshillin Bashkiak, Kryetarin e Njësisë Bashkiake apo Këshillin e Njësisë Bashkiake dhe **do të përfshijë fletët e votimit të hedhura jo në kutinë përkatëse**, të vecuara qoftë në zarfat e fletëve të konstestuar apo të pavlefshme (pavarësisht nga vend-ndodhja e tyre, zarfi i fletëve të votimit të pavlefshme apo të kontestuara). Procedurë kjo e cila është ndjekur nga vetë K.Q.Z. për aq sa ajo ka hetuar. Rezultatet e vlerësimit të votave duhet të pasqyrohen në proces-verbalet e mbledhjes së KQZ-së dhe në tabelat përkatëse.

Referuar në pikën "5" të nenit 118 të Kodit Zgjedhor me titull "vlerësimi i votave", në vijim të parashtrimit të procedurave në pikat "1", "2", "3", "4", jepet kuptimi dhe procedimi nga grupi i numërimit për fletët e votimit.

Vetëm nëpërmjet këtij hetimi të plotë administrativ dhe verifikimit të lëvizjes së fletëve të votimit të objekti hetimi administrativ nga një kuti votimi në tjetrën do të mundësohet zgjidhja e mospërmthjes së të dhënave në tabelën përmbledhëse dhe leximin e të gjithave votave pavarësisht se për kë janë



hedhur, Kryetar Bashkie, Këshill Bashkiak, Kryetar Njësie Bashkiake, apo Këshill Ky hetim duhet ti shërbejë zbatimit praktik të parimit të barazisë së votës, dhe pasqyrimit të vullnetit të të gjithë zgjedhësve.

Kolegji vlerëson se hetimi gjithëpërfshirës i shtrirë mbi numërimin dhe vlerësimin e të gjitha votave të hedhura në kutite e gabuara, pavarësisht se ku ndodhen ato dhe tabulimi i tyre në tabelën përmbledhëse garanton barazinë e votës, shqyrtimin e barabartë dhe të njëtrajtshtëm dhe leximin e vullnetit të shprehur të të gjithë zgjedhësve .

Në vijim sa më sipër, për sa kohë nuk ka një hetim gjithëpërfshirës të tabelës përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore, Kolegji vlerëson se vendimi Nr.827, datë 02.06.2011 duhet anuluar për pikat "2" dhe "3" të tij, pasi nuk mund të arrihet në një përfundim të caktuar .

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, në mbështetje nenit 158 pika "3" të Kodit Zgjedhor,

V E N D O S I

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë së paditësit Partia Socialiste e Shqipërisë.

2. Anullimin e vendimit Nr. 827 datë 02.06.2011. të KQZ për pikat "2" dhe "3" të tij, që bëjnë fjalë për rrëzimin e kërkesës ankimore Nr. 161 dhe 162 të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë.



3. Anullimin e vendimit Nr 710, datë 23.05.2011, të KQZ dhe vendimit Nr. 711 datë 23.05.2011 të KQZ.

4. Urdhërimin e palës së paditur KQZ-së të hapë rinumërojë dhe rivlerësojë votat e kontestuara në kutitë e pahapura (të materialeve zgjedhore) për Bashkinë Tiranë në 368-QV, për Kryetarin e Bashkisë Tiranë, Këshillin e Bashkisë Tiranë, Kryetarin e Njesisë Bashkiake dhe Këshillin e Njesisë Bashkiake, për votat që nuk janë hedhur në kutitë respektive të së njëjtës qëndër votimi dhe mbi bazën e tyre të shpall tabelën përmbledhëse të rezultateve për Kryetarin e Bashkisë Tiranë.

1. Rrëzimin për pjesën tjetër të kërkesë padisë.

Ky vendim është i formës së prerë.

U shpall në Tiranë me 13.06.2011

ANËTARE

Sashenka JONUZI

Kryetar

ANËTARE

Meriban MULLAJ

KRYESUESE

Dhurata HAVERI

ANËTAR

Maria QIRJAZI

Kryetar

ANËTAR

Astrit KALAJA

